

## NË EMËR TË POPULLIT!

Gjykata Themelore Ferizaj-Dega në Kaçanik, Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Shabi Idrizi me Sek. Juridike Shpresa Hoxha, në qeshtjen penale të akuzuarit [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] Rep. e Shqipërisë i akuzuar për shkak të veprës penale, kalimit të pa autorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 146 par 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës, së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II. nr. 1250 të datës 16.03.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar oral dhe të hapur më 27.12.2016 në prezencë të Prokurorit themelore Agim Kuka, dhe të akuzuarit [REDAKTUAR] mori dhe të njejtën ditë shpalli publikisht këtë:

## A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDAKTUAR] nga babai U [REDAKTUAR] dhe nëna [REDAKTUAR] e lindur [REDAKTUAR] i lindur [REDAKTUAR] në f. [REDAKTUAR] Rep e Shqipërisë ku edhe jeton, pregaditja shkollore shkolla fillore, i gjendje së veshtirë ekonomike, i pamartuar, i pa punë, shqiptar, shtetas i Republikës së Shqipërisë, pa shënime se më pare ka qenë i denuar, numri personal [REDAKTUAR].

## Ë S H T Ë F A J T O R

Se me dat 18.05. 2014, rreth orës 112:48 në vijën kufitare në fshatin Glloboqicë, Komuna Kaçanik, ka kaluar kufirin në mënyrë ilegale nga territori i Republikës së Maqedonis në territorin e Republikës së Kosovës, përmes fushës së lirë, ku pasi ka kaluar kufirin ishte vërejtur nga policia e cila e kishte ndaluar,-

Me këtë veprim ka kryer veprën penale kalimi i pa autorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 146 par 1 të KPRK-së.

Andaj duke u bazuar në dispozitën e lartcekur dhe neni 3, 41,46, 50,51, 75 të KPK-së dhe neni 365 dhe 453 të KPPK-së i shqipton

## D E N I M M E K U S H T

Ashtu që të akuzuarit [REDAKTUAR] i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 90(nëntëdhjet) ditëve, i cili nuk do të ekzekutohet po që se në afat prej një viti( koha e verifikimit) pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Konform dispozitës së neni 453 të KPPK-së lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore, për shkak të gjendjes së varfër ekonomike

## A r s y e t i m

PTH nga Ferizaji, me Aktakauzën PP/II. nr. 1250-2/14 të datës 16.03.2015 ,të akuzuarin [REDAKTUAR] nga f. [REDAKTUAR] e ka akuzuar për shkak të veprës penale, kalimit të pa autorizuar të vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 146 par 1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar - gjyqësor Prokurori Shtetëror Agim Kuka mbeti në tërsi pranë aktit akuzues paraqitur me shkrim pranë kësaj gjykate pa ndryshime dhe plotsime, duke propozuar gjykatës që të akuzuarin [REDAKTUAR] të e shpallë fajtor për veprën penale që akuzohet dhe ti shqiptoj denim merititor sipas ligjit .

I akuzuari [REDAKTUAR] në mbrotjen e tij në shqyrtimin fillestar-gjyqësor në tërësi e ka pranuar kryerjen e veprës penale që i veket në barrë sipas aktit akuzues dhe njëherit është penduar për këtë vepër penale dhe i propozon që gjykata të ia shqipton një denim sa më të butë.

Pasi që gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale që i veket në barrë dhe është e bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që përmban akt akuzues ka gjetur se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 248 par. 4 të KPK-së dhe shqyrtimin fillestar e ka përfunduar pa adminstrimin e provave tjera.

Gjykata vleron se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale kalimit të pa autorizuar të vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 146 par 1 të KPK-së për të cilën vepër i larpërmenduri është penalishtë përgjegjës dhe është ndeshkuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjës së denimit gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 dhe 75 i KPK-së të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjykata ka marrë për bazë pranimin e fajit nga i akuzuari, pendimin e tij, sjelljen e mirë të tij gjatë tërë procedurës si dhe në shqyrtimin fillestar, si dhe faktin se ai më parë nuk ka qenë i gjykuar dhe gjendjen e veshtirë ekonomike .

Gjykata është e bindur se denimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me shkallën e përgjegjsisë penale dhe peshën e vepres penale, keshtu që me denimin e shqiptuar, do arrihet qëllimi i denimit i paraparë me nenin 41 të KPK-së , ato rehabilitues që i njejti në të ardhmën të përmbahet nga kryerja porse të parandaloj edhe të tjerët që të kryejnë veper penale si dhe reagimin shoqëror ndaj një veprimi të tillë .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjyqësor është i bazuar në nenin 453 të KPPK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

Dega në Kaçanik

P. nr. 113/15

Me.27.12.2016

Sek. Juridike,  
Shpresa Hoxha

Gjyqtari,  
Shabi Idrizi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit, i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

